



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:024837

Datë: 04.08.2023

Numri i dokumentit: 04556257

C-IV-14-2052

Ankuesi

N D Kamenicë.

Kundër

E paditura

NSH “XIQ Karaqeva”, në Likuidim, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit,

Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me dt. 04 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. Vërtetohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, Nr. GJI045-0179, i datës 28 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 10 janar 2014, ankuesi ka dorëzuar një Kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), në të cilën ka kërkuar kompensimin për 3 paga të papaguara për periudhën kohore Maj-Korrik 2006 në shumë prej 900 € , nga N.Sh “XIQ Karaqeva” (në likuidim).

Autoriteti i Likuidimit me Vendimin nr. GJI045-0179, të datës 28 shkurt 2014, e ka refuzuar Kërkesën e paraqitur nga ankuesi, si të pavlefshme.

Me 27 mars 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI045-0179, të datës 28 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për 3 paga të papaguara, për periudhën kohore Maj-Korrik, në shumë prej 900 € nga N.SH “XIQ Karaqeva” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka qen punonjës i kësaj NSH-je dhe ka marr 20 %-shin nga privatizimi i NSH-së, ndërsa kërkesa e tij ka të bëjë me tri pagat e papaguara në shumë prej 900 euro. Ankuesi pohoi se me 15 gusht 2006 ka pranuar letrën nga zyra regjionale e AKP-së me të cilën i është thënë se punësimi i tij ndërpritet menjëherë, me tej ankuesi pohoi se në të njëjtën letër në paragrafin 3 thuhet se të gjitha pagat e papaguara të cilat punëdhënësi ju detyrohet sipas kontratës do të mbetet përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura. Ankuesi tutje pohon se me këtë AKP-ja i ka lënë në pritje që kërkesat e tyre të dorëzohen në procedurën e likuidimit. Ankuesi i propozon gjykatës që ta anuloj vendimin e AL-së dhe të aprovohet kërkesa e tij për pagat e papaguara. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar, Vendimin e kundërshtuar nr. Gji045-0179, të datës 28 shkurt 2014, dhe Njoftimin mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, i datës 15 gusht 2006.

Me 21 tetor 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e ankuesit, duke i konsideruar si të pa bazuara, dhe i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe dispozitave ligjore. E paditura AKP pohon se ankuesi nuk ka i ka përmbushur kushtet e parapara sipas nenit 40 paragrafi 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 04 maj 2023, gjykata lëshoi urdhër për të paditurën AKP-në, përmes së cilit urdhër e njoftoi se ajo ka parashtruar përgjigje në ankesë sa i përket një vendimi GJI045-0180, të cilin vendim ankuesi nuk e ka atakuar me këtë ankesë. Tutje e njoftoi se mund të paraqes përgjigje në ankesë sa i përket vendimit GJI045-0179, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri.

Me 23 maj 2023, e paditura AKP-ja parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe të dispozitave ligjore. AKP-ja e mbështet në tërësi vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke iu referuar Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, nenit 36.2.1, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, për rrjedhën e afatit të parashkrimit. Më tej e paditura pohoi se nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga maji i vitit 2006. E paditura i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL-së.

Me 01 qershor 2023 gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin, përmes së cilit urdhër ju kërkua që të dorëztoj Prova, në mbështetje të ankesës së datës 27 mars 2014 të ushtruar kundër vendimit të

Autoritetit të Likuidimit GJI045-0179, të datës 28 shkurt 2014, që dëshmojnë se NSH-ja i ka mbetur borxh ankueses pagat për periudhën kohore Maj- Korrik 2006, pra për tre pagat e fundit te pretenduara.

Ankuesi pranoi urdhrin e lartcekur me 08 qershor 2023, por i njëjti nuk ju përgjigj urdhrin të gjykatës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, GJI045-0179 i datës 28 shkurt 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me tre pagat e pa paguara në shumë prej 900 €, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e N.Sh-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i

lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. E paditura në vendimin e saj të AL e ka potencuar se kërkesa e parashtruesit duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se N.SH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën Maj-Korrik 2006. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrin të lëshuar nga gjykata të datës 01 qershor 2023, duke zgjedhur që të heshtë dhe mos ti përgjigjet të njëjtës. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit, për përfshirjen e tij në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar 20 % nga të ardhurat prej privatizimit, Gjykata e gjen si jo relevant në lidhje me këtë procedurë dhe si i tillë nuk ndikon në përfundimet e nxjerra, meqë ajo është çështje tjetër që është e rregulluar me procedurë dhe dispozita tjera.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është e liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit është nën 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar